

**Marrja nën kujdestari  
e fëmijëve  
azilkërkues të  
pashoqëruar**

**Kriza e refugjatëve - Çdo fëmijë është i  
rëndësishëm**

## Hyrja

---

Ne aktualisht jetojmë në një klimë ku qeveritë vendore po përballen me sfida të mëdha në përgjigjen ndaj krizës aktuale të refugjatëve. Për shërbimet e kujdestarisë në Hounslow, një nga sfidat kryesore është gjetja e kujdestarëve të specializuar për fëmijët nën kujdestari që kanë udhëtuar vetëm nëpër shumë vende duke kaluar trauma para se të mbërrijnë në Mbretërinë e Bashkuar, për të kërkuar azil.

Fëmijët e pashoqëruar azilkërkues kanë përjetuar dhe kanë udhëtuar përgjatë një rruge tjetër krahasuar me ata fëmijë që tashmë janë në kujdestari. Për shembull, disa nga fëmijët nën përkujdesje merren nën kujdestari për shkak të një sëmundjeje familjare, shkatërrimit të familjes dhe problemeve në familje ose një situatë ku nuk është përmbushur mirëqenia e tyre ose janë në rrezik lëndimi.

Shumë nga fëmijët në kujdes kanë përjetuar neglizhencë, abuzim fizik, emocional ose seksual.

Fëmijëve të pashoqëruar azilkërkues ju është dashur të largohen nga vendet e tyre ku ata janë përballur me trazira civile, ndarje nga të dashurit e tyre dhe humbje. Këta fëmijë janë detyruar të largohen nga atdheu nga miqtë dhe familjet e tyre, të cilët kanë dëshirë shumë që fëmijët e tyre të kërkojnë strehim, stabilitet dhe të mbrohen. Udhëtimi i fëmijëve në një vend të ri është i frikshëm pasi ju është dashur të lënë shtëpitë e tyre, prindërit dhe vëllezërit e motrat e tyre. Atyre ju është dashur të lënë një vend të njohur të quajtur vatër familjare, një vend ku ata e njihnin kulturën e tyre, gjuhën e tyre dhe rrjetet e tyre shoqërore.

Kur fëmijët e pashoqëruar azilkërkues hyjnë në Mbretërinë e Bashkuar pa prindërit ose kujdestarin e tyre atëherë ata merren në kujdesin e autoritetit vendor me shpresën që të gjendet një vend banimi me kujdestarë të miratuar që mund t'u ofrojnë atyre stabilitetin dhe mbështetjen për të cilën kanë nevojë që të përshtaten në shtëpinë e tyre të re. Shumë prej fëmijëve të pashoqëruar azilkërkues për të cilët kujdeset Hounslow janë nga

- Afganistani
- Shqipëria
- Eritrea
- Iraku
- Irani
- Vietnami.
- 

## Çfarë po kërkon Hounslow?

---

Hounslow po kërkon kujdestarë të specializuar që janë të gatshëm të marrin nën kujdestari fëmijë apo të rinj azilkërkues. Marrja nën kujdestari e një fëmije azilkërkues do të thotë të kujdesesh për një fëmijë apo fëmijë, të cilët nuk mund të jetojnë me familjen e tyre dhe t'u ofrosh kujdes, mbështetje dhe një shtëpi të sigurt.

Kujdestaria përfshin përmbushjen e nevojave të përditshme të fëmijëve. Mund të jetë edhe vetëm për disa ditë, disa muaj ose nganjëherë deri sa fëmijët të jenë gati të jetojnë të pavarur. Duke ju ofruar kohën dhe kujdesin tuaj ju mund t'u jepni fëmijëve kohën, hapësirën dhe mundësinë për të rindërtuar jetën e tyre.

Në përgjithësi kujdestarët janë nga të gjitha sferat e jetës dhe kanë prejardhje të ndryshme. Ajo që ata ndajnë është interesi që t'u japin fëmijëve nën kujdestari mundësinë për t'u rritur dhe për të ndryshuar si dhe të ndërtojnë një të ardhme të sigurt për veten. Kujdestarët janë disa nga profesionistët e shumtë të përfshirë në jetën e fëmijëve nën kujdestari, të cilët punojnë së bashku në interesin më të mirë të fëmijës.

Kujdestarëve që kujdesen për fëmijët e pashoqëruar azilkërkues do t'ju duhet të kenë durim, dhembshuri si dhe të kuptojnë kulturën e fëmijës me aftësinë për ta ushqyer atë kulturë. Kujdestarët do të duhet edhe t'i mbështesin fëmijët ose të rinjtë gjatë procesit të tyre të imigracionit dhe t'i ndihmojnë ata të integrohen në jetën në Mbretërinë e Bashkuar, ose ndoshta të përgatiten për kthimin e tyre nëse kjo gjë mund të bëhet në mënyrë të sigurt. Kjo mund të përfshijë që kujdestarët tanë të shoqërojnë fëmijët në Ministrinë e Brendshme.

Shumë fëmijë të pashoqëruar azilkërkues do të kenë edhe nevoja emocionale, praktike, gjuhësore dhe kulturore të cilat kujdestarët e tyre duhet t'i marrin në konsideratë. Kujdestarët do të kenë mundësi të përdorin dhe do të mbështeten nga përkthyesit nëse është e përshtatshme.

Kujdestarëve të miratuar dhe të ardhshëm do t'u bëhen trajnime të specializuara për të ndihmuar fëmijët që kërkojnë azil.

## Çfarë mbështetje u ofrohet kujdestarëve?

- Nëse hyni me rrjetin e kujdestarëve të miratuar në Hounslow, ne do të punojmë për t'ju siguruar që ju dhe fëmija nën kujdestarinë tuaj të jeni plotësisht të përkrahur që t'ia dilni me sukses
- Një paketë financiare bujare deri në 868,60 sterlina çdo dy javë, për një fëmijë
- Qasje në grupe të rregullta mbështetëse dhe aktivitete shoqërore argëtuese
- Trajnim i specializuar për kujdestarët, si dhe mundësi të vazhdueshme trajnimi
- Mbështetje 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, 365 ditë në vit
- Vizita të rregullta nga punonjësi(ja) juaj shumë i/e përkushtuar dhe me përvojë
- Karta falas për të bërë not dhe Merlin për kujdestarët dhe familjet e tyre

- Anëtarësim në organizatën bamirëse të pavarur Fostering Network
- Qasje te një psikolog klinik i brendshëm për këshilla në lidhje me çdo nevojë të veçantë për fëmijët tanë nën kujdestari
- Qasje te përkthyes dhe shërbimet e përkthimit në Hounslow
- Kujdestarët në Hounslow nuk do të pritet që të paguajnë asnjë taksë të bashkisë për periudhën kur ata kanë një fëmijë nën kujdesin e tyre.

## Kush mund të marrë fëmijë nën kujdestari?

---

Kujdestarët në Hounslow vijnë nga të kaluara të ndryshme. Ajo që është e rëndësishme është që ju të keni kohë, hapësirë dhe angazhim për t'u kujdesur dhe për të mbështetur fëmijën për të cilin po kujdeseni.

### **Për t'u bërë një kujdestar në Hounslow, ne kërkojmë që të gjithë aplikuesit të:**

- Jenë mbi 21 vjeç
- Të kenë një dhomë gjumi të lirë e cila është bosh në çdo kohë
- Të kenë leje qëndrimi të përhershme në Mbretërinë e Bashkuar
- Të mund të flasin, lexojnë dhe shkruajnë anglisht
- Të jenë në gjendje të mirë shëndetësore
- Kujdestarët duhet të kenë durim dhe mirëkuptim dhe të jenë të gatshëm të punojnë në partneritet me punonjës(in) social(e) të fëmijës për të siguruar një ambient të qëndrueshëm dhe të kujdesshëm për një fëmijë.

### **Kujdestarët në Hounslow mund:**

- Të jenë nga çdo lloj prejardhjeje etnike apo fetare
- Të jenë beqarë, të martuar ose që jetojnë me një partner(e)
- Të jenë heteroseksualë, lezbike apo homoseksualë
- Të jetojnë në pronë me qira, në pronësi ose të bashkisë
- Të jeni prind ose mund të jeni dikush që ka përvojë kujdesi për fëmijët.

Përkujdesja mund të jetë një detyrë sfiduese. Duhet të jeni në gjendje të mirë shëndetësore, t'i kuptoni dhe t'i pranoni vështirësitë me të cilat ballafaqohen fëmijët dhe familjet e tyre.

## Udhëtimi juaj për t'u bërë një kujdestar i miratuar

---

Të bëhesh një kujdestar nuk është një vendim që duhet marrë lehtë. Ne e kemi për detyrë të sigurohemi që ju të jeni një person i përshtatshëm për t'u kujdesur për fëmijët nën kujdestari, prandaj ka një proces gjithëpërfshirës për të kaluar para se të bëheni kujdestar i miratuar.

Mesatarisht, duhen gjashtë muaj për t'u bërë një kujdestar i miratuar në Hounslow.

## Faza paraprake

---

### Shprehni interesin tuaj që të bëheni kujdestar

Ju mund ta regjistrohni interesin tuaj:

- Duke plotësuar formularin e kërkesës në internet në faqen [www.hounslow.gov.uk/fostering](http://www.hounslow.gov.uk/fostering)
- Duke telefonuar 0800 731 8558
- Duke marrë pjesë në një aktivitetet informuese për kujdestarinë.

Në këtë fazë ne do t'ju dërgojmë një paketë informacioni me anë të postës elektronike ose postës së zakonshme.

Pasi të marrim shprehjen tuaj të interesit:

- Do t'ju telefonojmë që të plotësojmë një pyetësor, i cili do të zgjasë rreth 30 minuta
- Do të duhet të keni një dhomë tepër për të vazhduar në këtë fazë.

Në këtë fazë do të marrim një vendim nëse jeni të suksesshëm për të vazhduar në hapin tjetër.

### Njohja me njëri-tjetrin më mirë, përmes një vizite në shtëpi

Nëse jeni të suksesshëm, një punonjës(e) sociale(e) i/e rekrutimit nga ekipi i kujdestarisë do t'ju kontaktojë për të caktuar një datë dhe kohë për t'ju vizituar në shtëpi. Gjatë vizitës në shtëpi, ne do t'ju japim informacion në lidhje me:

- Kujdestarinë në më shumë detaje dhe do të shikojmë hapësirën që keni në dispozicion
- Përshtatshmërinë e shtëpisë tuaj
- Përcaktimin e motivimit tuaj për t'u bërë kujdestarë
- Llojet e fëmijëve që duhet të merren nën përkujdesje
- Mbështetja që do të merrni si kujdestarë.

Nëse të dyja palët vendosin të vazhdojnë me procesin, do të duhet të plotësoni një formular aplikimi për përkujdesjen dhe një formular pëlqimi që të bëheni kontrolluar ligjore.

## Faza 1

---

Faza 1 fillon kur marrim formularin tuaj të plotësuar të aplikimit.

Do t'ju kërkohet edhe që të merrni pjesë në trajnimin përgatitor të "Aftësive për t'u përkujdesur" të ofruar nga ekipi i kujdestarisë. Ky kurs ju ndihmon:

- të kuptoni angazhimin e nevojshëm për t'u kujdesur
- të mësoni rreth nevojave të fëmijëve nën kujdestari
- të zhvilloni aftësitë që ju nevojiten për të marrë nën kujdestari.

Ju do të keni mundësinë të takoni njerëz me të njëjtat ide që po përgatiten të kujdesen ose aktualisht po kujdesen për fëmijë dhe të rinj.

Në trajtim janë përfshirë një numër temash kyçe përfshirë:

- Roli i kujdestarëve
- Promovimi i identitetit kulturor dhe mundësive të jetës
- Sfidat dhe shpërblimet e përkujdesjes
- Zhvillimi i fëmijës
- Kujdesi më i sigurt
- Lëvizja e fëmijëve në vendbanimin e tyre të ri ose kthimi për të jetuar me familjen ose të afërmin e tyre biologjikë.

Gjatë kësaj faze bëhen kontrollimet në vijim me pëlqimin tuaj:

- Kontrollë të policisë/DBS i zgjeruar
- Kontrollë mjekësore
- Kontrollë të punësimit
- Kontrollë financiare
- Referencat profesionale dhe personale.

Pasi të jenë bërë kontrollet dhe të jenë marrë informacionet, ju do të informoheni për vendimin për të vazhduar në Fazën 2 brenda 10 ditësh pune.

Nëse gjatë Fazës 1 vendosim të mos vazhdojmë me vlerësimin tuaj, ne do t'ju shkruajmë për t'ju informuar për vendimin tonë dhe arsyet për këtë.

## Faza 2

---

Në fazën 2 fillon procesi i vlerësimit. Gjatë vlerësimit, aplikuesit;

- Do t'i caktohet një punonjës(e) sociale(e) i/e rekrutimit i cili /e cila do t'ju vizitojë 6-8 herë për të përfunduar një formular vlerësimi gjithëpërfshirës
- Do të bëhet vlerësim i shëndetit, sigurisë dhe pajisjeve
- Për familjet që jetojnë në banesa me qira private, kërkohet një marrëveshje me shkrim nga qiradhënësi
- Ka një grant fillestar në dispozicion të aplikuesve për të blerë mobile/pajisje thelbësore për të plotësuar nevojat e fëmijës nën kujdestari
- Aplikuesve do t'ju jepen disa detyre me shkrim për të përfunduar mes vizitave për t'i shtuar në vlerësim.
- Gjatë vlerësimit do të përpilohet një Formular F i vlerësimit.

## Takimi me panelin e kujdestarisë dhe miratimi

---

Në fund të udhëtimit tuaj do t'ju kërkohet të merrni pjesë në një panel të kujdestarisë. Ky panel përbëhet nga një grup profesionistësh të cilët kanë përvojë pune me fëmijët, ose mund të kenë vetë kujdestarë. Ne do t'ju ftojme të takoheni me panelin e kujdestarisë, i cili do të bëjë një rekomandim për kujdestari në bazë të:

- Informacionit në raportin e vlerësimit përfshirë në Formularin F
- Takimit me ju personalisht.

Vendimi përfundimtar në lidhje me përshtatshmërinë tuaj për t'u bërë kujdestarë merret nga një vendimmarrës i agjencisë në Bashkinë në Hounslow.

## Pasi të jeni një kujdestar, ne do t'ju përkasim me fëmijën e duhur

Sapo të miratoheni, do të fillojë udhëtimi juaj si kujdestar(e). Ju do të merrni

---

trajnim dhe mbështetje të vazhdueshme për t'ju ndihmuar të promovoni rezultate pozitive për fëmijët në kujdesin tuaj, duke u mundësuar atyre që të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

**Duke zgjedhur të bëhesh një kujdestar mund të bësh një ndryshim të madh në jetën e fëmijës - dhe tënden.**

## **Kontaktioni ekipin e kujdestarisë:**

Na telefononi

**0800 731 8558**

Na dërgoni email në

**[fostering@hounslow.gov.uk](mailto:fostering@hounslow.gov.uk)**

Ose vizitoni faqen tonë të internetit

**[www.hounslow.gov.uk/fostering](http://www.hounslow.gov.uk/fostering)**